



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2020:007256

Datë: 05.01.2023

Numri i dokumentit: 03828351

C.nr.574/2019

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari **Betim Behluli**, me bashkëpunëtorin profesional **Armond Omega**, në çështjen juridike të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS) me seli në Prishtinë, kundër të paditurit S. (Sh.) R. nga Rahoveci, për rimbursimin e dëmit, vlera e kontestit 105,00 €, jashtë shqyrtimit **me dt.10.11.2022**, mori këtë:

A K T G J Y K I M
PËR SHKAK TË PADEGJUESHMËRISË (MOSBINDJES)

MIRATOHET në tërësi kërkesë – padia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS) me seli në Prishtinë, ashtu që të **DETYROHET** i padituri S. (Sh.) R. nga Rahoveci, që në emër të kompensimit të dëmit t'ia paguaj shumën prej 105,00 €, (**njëqind e pesë euro**) me kamatën përkatëse ligjore 8% në vit, nga dita e paraqitjes së padisë datë 16.12.2019, e gjerë te pagesa definitive, si dhe në emër shpenzimeve procedurale shumën prej **20,00 € (njëzet euro)**, e të gjitha këto në afatin prej 15 ditëve nga dita e marrjes së Aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Pala paditëse në padi ka theksuar se i padituri me datën 19.11.2018, rreth orës 10:20 në Prishtinë, ka shkaktuar aksident trafiku me automjetin e tij Daimler, me targa të regjistrimit ...-...-....

Në bazë të provave si Ujdia Jashtëgjyqësore, BKS-ja, me Nj. S. nga Prishtina, vërtetohet se në emër të dëmit material, të pësuar në këtë rast të dëmit, BKS-ja, dhe e dëmtuara u dakorduan që të dëmtuarit ti paguhet në emër të zhdëmtimit shuma prej 105,00 €.

Gjykata në kuptim të nenit 394 të Ligjit për procedurën kontestimore nr.38/2008 i publikuar në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës” me dt.05.11.2021, i ka dërguar të paditurit padinë dhe Aktvendimin për dhënien e përgjegjës në padi.

Duke e bërë shikimin në flete dërgesën për dorëzim personal konstatohet se i padituri i lartpërmendur e ka pranuar personalisht Aktvendimin C.nr.574/19 të dt.05.11.2021, padinë dhe provat me dt.22.11.2021, i njëjti i ka pranuar, andaj duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit

150.1 të LPK-së, të larte cituar Gjykata mori Aktgjykim për shkak të pa dëgjueshmërisë (mosbindjes) ndonëse janë plotësuar kushtet siç më poshtë vijojnë:

a) Të paditurit i është dorëzuar në mënyrë të rregullt padia, provat materiale dhe thirrja aktvendimi për dhënien e përgjegjës në padi,

b) Themelësia e kërkesë-padisë rezulton nga faktet e treguara në padi, dhe

c) Faktet mbi të cilat mbështetet kërkesë-padia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi.

Andaj, në kuptim të nenit 160.6 të Ligjit për procedurën kontestimore janë dhënë vetëm arsyet e sipërcituara që e justifikojnë marrjen e këtij Aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u vendos komfor nenit 452.1 të LPK, me ç ‘rast palës paditëse i janë pranuar shpenzimet në emër të taksave gjyqësore shumë prej 20,00 €.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC,
C.nr.574/2019, me datë 10.11.2022**

B. Profesional
Armond Qmega

**Gjyqtari
Betim Behluli**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, ankesa paraqitet nëpërmjet të kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit, Divizioni Civil në Prishtinë.